



26-11-2018

*CM*

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

Numri i lëndës: 2018:062143  
 Datë: 24.10.2018  
 Numri i dokumentit: 00153727

**P.nr.3331/17**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL**, me gjyqtari e vetëm gjykues Ilir Bytyqi, me procesmbajtesin Visar Haliti, praktikantin i kësaj gjyqate, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga Fsh. [REDACTED] K. Kaçanik, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2349-3/17 të dt 28.12.2017, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor - dënim me gjobë, gjykata me datën 15.10.2018 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**APROVOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2349-3/17 e datës 28.12.2017 dhe gjykata jep këtë:

**URDHËR NDËSHKIMOR**

**I akuzuari:** [REDACTED] i lindur me datë, [REDACTED], me vendbanim në fsh. [REDACTED] Komuna Kaçanik, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] ka te kryer shkollen e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. Personal [REDACTED], mbrohet në liri.

**ËSHTË FAJTOR**

Se më dt. 04.10.2017, rreth orës 15:20, në rrugën magjistrale Kaçanik-Prishtinë, duke drejtuar automjetin-kamionin e tipit “MAN Lox-F”, ngjyrë e bardhë, me targa të regjistrimit [REDACTED] nga pakujdesia ka rrezikuar jetën e njerëzve, ashtu që duke vepruar në kundërshtim me nenin 120 par. 1 të

ligjit mbi trafikun publik, me të arritur përballë restorantit "Zeka", nuk e mban distancën e duhur në mes automjeteve, për pasojë me pjesën e përparme të anës së majtë e godet në pjesën e pasme të anës së djathtë automjetin e tipit "VW Tiguan", ngjyrë metalike, me traga të regjistrimit [REDAKTUAR], të cilën e drejtonte [REDAKTUAR] ku nga aksidenti përveç dëmeve materiale lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin pësojnë vozitësi i njësisë dy dhe pasagjeri i tij [REDAKTUAR].

**me të cilën kreu veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.**

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPK-së dhe neneve 365 e 495 të KPPK-së, i shqipton

#### **DËNIM ME GJOBË**

- Të akuzuarit [REDAKTUAR] i shqiptoi dënimin në shumën prej 250 Euro (dyqind e pesëdhjetë), të cilën shumë i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.
- Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.
- Të dëmtuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohen në kontest civil.
- Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro /njëzet/, si dhe shpenzimet e procedurës penale expertiza mjekoligjore dhe expertiza e komunikacionit në shumën prej 90.88 Euro /nëntë dhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent/, në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prërë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.
- Obligohet i akuzuari që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

#### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.2349-3/17 të dt 28.12.2017 ka akuzuar [REDAKTUAR] me vendbanim ne fsh. [REDAKTUAR], Komuna Kaçanik, për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, njëherë aktakuzës i ka bashkangjitur kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga ana e të pandehurit.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1. të KPPK-së.

Gjykata duke i vlerësuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: ekspertiza e ekspertit të komunikacionit rrugor të dt. 29.11.2017, ekspertiza mjeko-ligjore të dt. 16.12.2017, deklarata e të pandehurit [REDAKTUAR] e dt. 04.11.2017, deklarata e të dëmtuarit [REDAKTUAR] e dt. 04.11.2017, fotografit te cilat gjenden ne shkresat e lendes si dhe provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe raporti i aksidentit 2017-CFT-725 dt.04.11.2017, vlerësojë se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtën e shpalli fajtores dhe i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet paushall është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPK-së.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.


### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.3331/17 i dt.15.10.2018

Procesmbajtës,

Visar Haliti

Gjyqtari: Ilir BYTYQI



**UDHËZIM JURIDIK:** Kudër këtij aktgjykimi lejohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të dërgesës së njëjtit, gjyqtarit të vetëm gjykues të kësaj gjykate, përmes kësaj gjykate. Pas skadimit të afatit të lejuar për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor bëhet i plotfuqishëm dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.